INTERVISTË ME FRANZISKA VON STENGLIN

Tiranë
Kohëzgjatja: 37 minuta

Të pranishëm:

1. Franziska Von Stenglin (E intervistuara)
2. Diona Budima (Intervistuesja)
3. Ana Morina (Kamera)

Diona Budima: Për të filluar, a mund ta thoni emrin tuaj të plotë, ku dhe kur keni lindur, e pastaj të na tregoni pak për prejardhjen tuaj dhe si keni mbërritur te praktika artistike që zhvilloni sot?

Franziska Von Stenglin: Quhem Franziska Von Stenglin. Jam artiste dhe regjisore. Kam lindur në Mynih, në vitin 1984. Gjatë jetës kam lëvizur shumë, sepse babai im punonte në shërbimin diplomatik gjerman. Pra, jam gjermane, por gjatë rritjes kam kaluar po aq kohë jashtë vendit sa edhe në Gjermani. Kështu që, po, ndoshta kaq për fillim...

Diona Budima: Si ishte kjo përvojë?

Franziska Von Stenglin: ...Mendoj se ishte edhe e dobishme. Për mua ishte e mrekullueshme. Kam dy vëllezër, një më të madh dhe një më të vogël. Mendoj se ishte një privilegj i madh të mund të jetoja në vende të ndryshme dhe të njihja njerëz, rrethana, gjuhë e kultura të tjera, brenda këtij konteksti që, natyrisht, ishte shumë i privilegjuar: të ishe fëmijë diplomati. Mendoj se është një nga format më të mira të arsimimit që mund të marrësh.

Dhe po, më pëlqente shumë. Sigurisht që kjo përvojë nuk vjen pa vështirësitë e veta, por për mua ishte një dhuratë e jashtëzakonshme. Edhe unë jam njeri shumë i hapur, prandaj e kisha më të lehtë të ndërroja shkollë dhe të përshtatesha me rrethana të reja. Për shembull, vëllai im i madh është pak më introvert. Për të nuk ishte aq e lehtë dhe ndryshimet në jetën e tij, sidomos ndërrimi i shkollës në mes të vitit shkollor e gjëra të tilla, ishin më të vështira. Për mua, përkundrazi, ishte përvojë shumë e bukur.

Diona Budima: A ju duhej t'i mësonit të gjitha gjuhët e ndryshme?

Franziska Von Stenglin: Jo, nuk ishte e detyrueshme. Kur isha në moshën e kopshtit, jetonim në Senegal. E mbaj mend shumë qartë që më dërguan në një kopsht në gjuhën frënge, sepse Senegali kishte qenë koloni franceze, dhe unë e urreja. Më kujtohet shumë mirë ajo ndjesi, sepse gjithçka ishte jashtëzakonisht e disiplinuar dhe shumë... po, shumë franceze [bën gjestin e puthjes së majave të gishtave]. Kurse unë nuk isha aspak e tillë.

Pastaj duhet të kem bërë aq shumë zhurmë, saqë prindërit më regjistruan në një parashkollor amerikan. Atje më pëlqente shumë: kishte edhe grupin Daisy të Girl Scouts dhe, nuk e di, gjithçka ishte shumë më e çlirët dhe më argëtuese. Kështu mësova pak frëngjisht, por pastaj e mësova anglishten shumë mirë. Më pas shkuam në Gjermani dhe, në kopshtin parashkollor atje, në Bonë, i harrova të gjitha.

Pastaj shkuam në Indi dhe m'u desh ta mësoja anglishten përsëri, sepse ajo ishte një nga gjuhët e përdorura nga qeveria, krahas hindishtes. Flitej anglisht gjatë gjithë kohës, kështu që e rimësova. Prindërit e mi, për zhgënjimin e tyre, nuk arritën kurrë të më bënin ta mësoja frëngjishten aq mirë sa anglishten. Më thoshin: "Duhet ta mësosh frëngjishten. Duhet ta mësosh frëngjishten." Por nuk e desha kurrë vërtet. Ndoshta për shkak të asaj traume të fëmijërisë nga kopshti. Nuk arrita ta pëlqeja frëngjishten.

Mësova ca, por jo shumë mirë. Pra, jo, nuk e flas. Di pak hindisht, disa fjalë e fjali, por asgjë më shumë. Kështu që anglishtja ishte në thelb e vetmja gjuhë që e mësova vërtet shumë mirë. Po.

Diona Budima: Po si u përfshitë në...

Franziska Von Stenglin: Në praktikën time artistike, po. Nëna ime është artiste. Është piktore shumë e mirë. Edhe vizaton shumë mirë. Ka studiuar art, por nuk e bëri kurrë karrierë prej tij. Ishte e martuar me babanë tim dhe lëvizte me të çdo dy-tri vjet, kështu që nuk qëndronte kurrë në një vend aq gjatë sa të ndërtonte një karrierë. Përveç kësaj, nuk kishte as vetëbesimin e nevojshëm për ta bërë këtë. Është vërtet e zonja, por edhe sot e kësaj dite nuk beson shumë te puna e vet.

Prandaj arti ka qenë gjithmonë shumë i pranishëm në familjen tonë. Edhe babai im e mbështeste shumë artin. Në çdo vend ku jetonim, gjenin vepra që u pëlqenin dhe blinin disa prej tyre. Nuk ishin koleksionistë në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por blinin punime të artistëve që i vlerësonin.

Disa prej atyre artistëve më vonë u bënë shumë të suksesshëm. Por blinin edhe vepra në vende të ndryshme, për shembull art indigjen, apo punime të këtij lloji. Kjo ishte gjithmonë pjesë e jetës sonë. Shkonim vazhdimisht në muze, nëna ime... Pra, arti ishte aty. Mendoja se do të merresha me të, por e përfytyroja diçka më të aplikuar, si dizajni. Më duket se fillimisht më tërhiqte dizajni i brendshëm.

Në fund, përfundova duke studiuar fotografinë, sepse mendoj se fotografia është një lloj porte hyrëse për shumë artistë. Është një mënyrë për ta ushtruar shikimin, për të mësuar si ta vëzhgosh botën dhe si ta regjistrosh atë. Më duket se shumë të rinj fillojnë të merren me fotografi kur nisin të zhvillojnë një praktikë artistike. Unë studiova fotografi në Londër, por pastaj mendova: “Kjo është disi tepër e ngurtë, tepër e kufizuar.”

Doja të merresha me artet e bukura. Fillova të studioja artet e bukura dhe pastaj mendova: “Kjo është tepër e çmendur. Çfarë dreqin?!” Më pëlqente shumë, por njëkohësisht mendoja: “Uau, tani kjo po bëhet...” Edhe sot, ndërkohë që merrem edhe me filma — një medium që e zbulova pas përfundimit të shkollës së artit dhe që nuk e kam studiuar kurrë — më pëlqen jashtëzakonisht shumë. Është diçka që e dua vërtet ta bëj. Vazhdoj të punoj me fotografinë, instalacionin dhe arkivat, e kështu me radhë. Pra, gjithçka është një lloj universi...

Diona Budima: Cilat janë pyetjet apo temat kryesore që përsëriten në punën tuaj?

Franziska Von Stenglin: E di çfarë? Gjithmonë mendoj se artistëve u kërkohet ta shpjegojnë... Pritet prej nesh të jemi shumë të zotë për ta artikuluar praktikën tonë. Ua kam zili artistëve që dinë ta bëjnë këtë mirë, që arrijnë ta përcaktojnë saktësisht se çfarë i intereson. Mund t’ju tregoj se çfarë më intereson mua, por e kam shumë të vështirë ta shpreh me elegancë, ndonjëherë edhe ta artikuloj qartë se për çfarë bëhet fjalë në punën time, sepse...

Diona Budima: Po, nuk ka problem. Sepse ju punoni me një medium tjetër.

Franziska Von Stenglin: Po, po. Jo, dhe gjithmonë mendoj kështu: “Për këtë i kemi historianët, kuratorët dhe kritikët e artit. Kjo është puna e tyre. Përndryshe, çfarë do të bënin nëse unë do t’i shpjegoja të gjitha?” Mendoj se temat që përsëriten në punën time janë njerëzimi dhe ajo që na bën njerëzorë. Më pëlqejnë fotografia dhe filmi, sepse të dyja janë mediume shumë demokratike. Filmi, për shembull, sot përdoret nga të gjithë. Çdokush mund të bëjë filma me telefonin e vet.

Edhe fotografia është një medium për të ndarë gjëra me të tjerët. Ajo është përdorur edhe për ta shpërndarë artin: fotografoheshin veprat e artit dhe fotografitë e tyre shpërndaheshin në kartolina.

Kështu, çdokush mund ta kishte një pikturë të Renoir-it në shtëpi, ose diçka të ngjashme. Pra, është një medium popullor. Kjo paraqet edhe një problem për botën e artit, sepse nuk dinë mirë si të merren me të: fotografitë nuk janë ekzemplarë unikë.

Ato shtypen në tirazhe të caktuara dhe, për këtë arsye, nuk konsiderohen mjaftueshëm të çmuara për t'u shitur me çmime të larta e gjëra të tilla. Por pikërisht kjo më pëlqen. Më pëlqen edhe fakti që fotografia dhe filmi paraqesin gjithmonë një formë të realitetit. Prandaj janë të qasshme për njerëzit e zakonshëm: shohin diçka me të cilën mund të lidhen, diçka që u ofron të paktën një pikë hyrëse. Për më tepër, janë lehtësisht të shpërndashme.

Pra, demokracia... njerëzimi... Më intereson të tregoj se si përdoren gjërat në jetën e përditshme, si jetojnë njerëzit, çfarë i prek dhe çfarë ka rëndësi për ta. Po, kjo është patjetër një temë që përsëritet në punën time. Edhe arkivat janë një temë e përsëritur. Punoj shumë me arkiva. Udhëtoj shumë. Ende e bëj këtë, sepse gjëja që më pëlqen më së shumti është të shkoj në vende të ndryshme dhe të mësoj gjëra të reja. Më pëlqen të jem gjithmonë kureshtare për njerëzit, për vendet ku jetojnë, për mënyrën dhe arsyet pse jetojnë ashtu, si dhe për dallimet mes përvojës së tyre dhe asaj timen. Po, po. Këto janë disa nga gjërat...

Diona Budima: E përditshmja. Dhe mendoj se në tekstin përshkrues përmendet "banalja..."

Franziska Von Stenglin: Po.

Diona Budima: ...që shfaqet në punën që keni krijuar këtu, apo në ekspozitën që keni kuruar. A mund ta përshkruani fillimisht, që ta kemi të dokumentuar, dhe pastaj të na tregoni pak se si lindi, si dhe me cilat pyetje po merreshit?

Franziska Von Stenglin: Kurova një ekspozitë me fotografi që vijnë nga inventari i Institutit të Antropologjisë në Tiranë. Ky inventar është një koleksion fotografish etnografike, pra fotografi të realizuara për qëllime etnografike. Ato janë ngjitur në karton dhe sistemuar në dosje me mekanizëm unazor. Përzgjodha në mënyrë eklektike fotografi nga ky koleksion — mendoj se ishin mbi 70 — dhe organizova një ekspozitë në studion time, në dhomat e ndryshme të studios.

Për mua, kjo përzgjedhje është e gëzueshme. Ka humor, poezi, misticizëm, skena që të kujtojnë filmin, një dhomë kushtuar modës, si dhe disa elemente queer, disa fotografi queer. I vendosa nëpër mure në mënyrë që imazhet të komunikonin me njëra-tjetrën, duke krijuar histori të ndryshme, poezi të ndryshme, do të thosha.

E zbulova këtë inventar, i cili ka një funksion shumë praktik. Këto fotografi nuk janë menduar si vepra arti. Ato shërbejnë si një arkiv vizual dhe si dokumentim i asaj që ekziston: veshjeve, objekteve dhe ritualeve. Por janë të bukura. Janë vërtet magjike.

Shumë prej tyre janë realizuar nga fotografë etnografikë jashtëzakonisht të talentuar. Mbeta krejtësisht e mahnitur prej tyre. Arkivat më kanë fascinuar gjithmonë. Njëkohësisht, ato mund të jenë edhe frikësuese, sepse janë si puse pa fund informacioni: futesh brenda dhe nuk del më. Të kaplon ndjesia: "O Zot, sa shumë informacion, është e tepërt..." Në këtë rast, fillimisht pashë tri-katër fotografi, ose na i treguan gjatë vizitës në arkiv, dhe mendova: "Ky është një fond fotografik i jashtëzakonshëm."

Pastaj Olsi, drejtori, më tregoi se në Tiranë nuk ka pasur muze etnografie — mendoj që nga viti 2008.

Mos më citoni për këtë, por, me sa duket, ndërtesa u nevojitej për diçka tjetër. Tani kanë vetëm një lloj hapësire për ruajtjen e arkivit, ku mbahen të gjitha objektet dhe fotografitë në dollapë të mëdhenj.

Për mua, pjesa më e këndshme ishte përzgjedhja e këtyre fotografive dhe kurimi i ekspozitës. Por, natyrisht, ky arkiv është edhe shumë i ngarkuar politikisht. Ai ka një qëllim shumë të qartë: u krijua gjatë regjimit komunist dhe shërbente për ndërtimin e identitetit kombëtar.

Ka shumë gjëra që nuk janë thjesht dokumentim i traditave të zakonshme popullore, në kuptimin "po ndodh diçka, po e fotografoj". Në to ka shumë inskenim, shumë kulturë të vënë në skenë posaçërisht për arkivin, për t'u dokumentuar. Olsi tha gjithashtu — dhe do të flasim për këtë edhe më vonë — se "vetë dokumentimi është pjesë e shkatërrimit".

Pra, ka gjëra që regjimi dëshironte t'i ruante dhe t'i mbyllte brenda arkivit, por pa i lejuar të vazhdonin të ekzistonin në botën reale. Disa rituale, për shembull, sepse feja nuk ishte diçka që e pëlqenin. Shumë rituale osmane, me sa kuptoj, përpiqeshin t'i mohonin, t'i zhduknin, t'i bënin të mos ekzistonin më. Por njëkohësisht donin ta ruanin njëfarë misticizmi të romantizuar.

Kështu që i ruan në arkiv dhe mund të kthehesh te to, por ato, në të vërtetë, nuk ekzistojnë më në jetën e përditshme. Diçka e tillë... Kjo m'u duk shumë interesante. Dhe, sigurisht, ka edhe të gjitha gjërat që nuk janë dokumentuar. Një arkiv, përmes gjithçkaje që përmban, flet edhe për gjërat që mungojnë. Në të ka edhe fotografi të realizuara nga fotografë të mrekullueshëm të Shkodrës, nga dinastia Marubi, dhe [e padëgjueshme].

Ato janë pjesë e arkivit për shkak të veshjeve që njerëzit kanë në fotografi ose të gjërave që po bëjnë. Është, pra... do të flasim më shumë për këtë me Olsin sonte, por bëhet fjalë për një arkiv të jashtëzakonshëm, të çuditshëm, të bukur dhe të ndërlikuar. Për mua, ishte e rëndësishme të vija këtu dhe ta shfrytëzoja këtë platformë të Art Explora-s, këtë vilë, që është tashmë një hapësirë me histori të vështirë, dhe të mos vija thjesht për të prodhuar punën time, e cila më shërben vetëm mua.

Dua të them, jo vetëm mua, por... të bëja diçka që ka vlerë edhe në një kuptim më të gjerë, që u shërben njerëzve këtu, hapësirës ku ndodhem, qytetit dhe vendit në tërësi. Mendova se, nëse mund ta shfrytëzoja këtë hapësirë dhe këtë platformë të studiove të hapura në një mënyrë kuptimplotë, duke bërë këtë përzgjedhje dhe këtë ekspozitë, ndoshta do të mund të shërbente si një formë avokimi për krijimin e një muzeu në një të ardhme jo shumë të largët. Ky ishte qëllimi.

Prandaj i kërkova Olsit t'i merrte këto fotografi, t'i vendoste në mur dhe t'i kthente pasi të përfundonte ekspozita. Në fillim, ai donte të më pyeste nëse dëshiroja të bënim printime, t'i skanonim dhe pastaj t'i shtypnim.

Mendoj se ato tashmë i kanë të skanuara. Gjithsesi, po diskutonim si do ta zgjidhnim çështjen e të drejtave të autorit. I thashë: "Jo, nuk dua. Dua vetëm... nëse je dakord, do t'i merrja këto kartona, do t'i vendosja në mënyrë që të mos dëmtohen dhe pastaj do t'i ktheja aty ku ishin."

Ai tha: "Mirë, kjo është e çuditshme." Ai po përpiqet prej disa vitesh të sigurojë nga qeveria një muze dhe financimin për të, por deri tani nuk ia ka dalë. Kështu që nuk e di nëse kjo do të ndihmojë, por, po.

Diona Budima: Po i pyesim të gjithë rezidentët për marrëdhënien e tyre me këtë vend.

Franziska Von Stenglin: Po.

Diona Budima: Sepse, natyrisht, ky është një vend me një histori shumë të ngarkuar dhe për shumë njerëz këtu zgjon trauma. Në rastin tuaj, kjo lidhet ngushtë edhe me punën tuaj, sepse njerëzit që kanë jetuar këtu kanë marrë vendime të caktuara, të cilat kanë përcaktuar edhe mënyrën se si është formuar arkivi.

Franziska Von Stenglin: Po.

Diona Budima: E keni prekur pak këtë temë, por do të doja të ndaleshim edhe më shumë te ajo. Çfarë mendoni se sjell ndërhyrja juaj kur e kuroni arkivin në një mënyrë tjetër nga ajo e zakonshmja? Si lidhet kjo me faktin që jeni këtu dhe si reflekton historinë e këtij vendi? Ndoshta mund të flisni pak më shumë për zgjedhjet estetike që keni bërë: çfarë keni zgjedhur të theksoni dhe si jeni marrë me mungesat që përmendët — me faktin se arkivi ndërtohet po aq nga ato që nuk i paraqet, sa edhe nga ato që i paraqet.

Franziska Von Stenglin: Mendoj se të gjitha këto diktatura, të gjitha këto regjime — edhe ato që kemi pasur ne në Gjermani — nuk kanë vetëm anë të këqija. Natyrisht që ka pasur shumë vuajtje dhe gjëra të tmerrshme, por duhet thënë edhe diçka për prodhimin artistik apo etnografik të mbështetur nga shteti, i cili, sigurisht, udhëhiqej nga ideologjia. E njëjta vlen për filmat e Kinostudios dhe për ato që kam parë këtu, pasi kam shikuar shumë filma të periudhës së Kinostudios në arkivin e filmit. Natyrisht, ka shumë propagandë.

Por ka edhe punë jashtëzakonisht të mira. Vërtet të jashtëzakonshme. Për shembull, Xhanfize Keko. Puna e saj është e mrekullueshme. Edhe në rastin e filmave shumë propagandistikë, si ata të Dhimitër Anagnostit, ai mund të ketë bërë filma të tillë, por është thjesht një gjeni. Është i jashtëzakonshëm. Edhe në rastin e këtij arkivi, qëllimi mund të kritikohet — për nacionalizëm, shtypje apo diçka të ngjashme.

Por rezultati, të paktën nga këndvështrimi im, nga ajo që shoh në mure dhe në arkiv, si dhe nga reagimet e disa vizitorëve që kanë ardhur në studio — jemi në ditën e tretë të ekspozitës — ka qenë shumë pozitiv. Njerëzit mahniten. Pyesin: "Çfarë është kjo? Ah, kjo është nga qyteti im. Nuk e kam parë kurrë më parë. Sa interesante!" Pra, shoh shumë gjëra pozitive dhe shumë bukuri në të. Mendoj se rezultati është i mirë, edhe pse e gjithë kjo është shoqëruar me shumë vuajtje. Dhe etnografia, me të drejtë, konsiderohet mjet shtypjeje.

Duhet pyetur edhe se sa pëlqim kanë dhënë njerëzit në raste të caktuara. Ka fotografi që nuk i përzgjodha. Dua të them, kishte jashtëzakonisht shumë fotografi për të zgjedhur dhe shumë gjëra që i lashë jashtë, edhe për shkak se nuk kisha hapësirë të mjaftueshme. Por kishte edhe fotografi të njerëzve shumë të varfër, ku kuptohej se, me gjasë, nuk ishte marrë pëlqimi i tyre.

Dukeshin thjesht njerëz që rrinin në ndonjë treg. Nuk e di më saktësisht në cilin qytet apo vend ishin bërë fotografitë. Por m'u dukën disi tepër voyeuriste, sikur po i vështroja njerëzit pa të drejtë. Pastaj kishte edhe fotografi ku shihej qartë pëlqimi i personit dhe ndërveprimi i tij me fotografin. Më falni, preka mikrofonin. Është fjala për një nga pararendësit... një lloj autodidakti...

Doruntina Vinca: [e padëgjueshme]

Franziska Von Stenglin: [e padëgjueshme] Dhe ai ka realizuar fotografitë më të mira. U bëra shumë kureshtare: si dukej ky njeri? Mendova: "Si duket ai?" Pastaj i kërkova Olsit një fotografi të tij dhe, kur ia pashë fytyrën, mendova: "Ah, kuptohet..." Mund ta kuptosh pse njerëzit reagojnë ndaj tij në një mënyrë të caktuar.

Duket si njeri i këndshëm, që di të komunikojë me të tjerët. Por, nga ana tjetër, siç e kuptova, ai është edhe problematik politikisht. Praktikonte një lloj... Dhe këtu Olsi duhet të flasë, sepse unë nuk jam etnografe dhe nuk di mjaftueshëm për këtë temë.

Por Olsi më tha se ai ndiqte edhe një qasje të etnografisë gjermane, që lidhej me mbledhjen e të dhënave dhe klasifikimin racor, e kështu me radhë. Pra, në këtë kuptim... Megjithatë, ajo që shoh këtu sot, ajo që ka mbijetuar dhe që ende ekziston, më bën të mendoj se është e rëndësishme të punohet me këto fotografi dhe të ekspozohet ky material. Duhet bërë i qasshëm arkivi, për shembull përmes një muzeu, ku mund të krijohet një marrëdhënie dhe ndërveprim me publikun.

Atëherë mund të shtrohen dhe të trajtohen të gjitha këto pyetje. Njerëzit mund ta shohin arkivin dhe, njëkohësisht, ta admirojnë, sepse ka diçka... nuk e di, duket si një thesar mistik. E urrej ta përdor këtë fjalë, por këtu ka edhe shumë romantizim. Dhe kjo është diçka shumë interesante.

Në njërën prej fotografive shihet një kamerë filmi dhe një burrë që e mban atë, shumë pranë barinjve. Ata kanë veshur kostume tradicionale dhe po ndajnë delet. E kupton menjëherë se kjo është inskenuar për kamerën. Ka shumë inskenime. Vërtet shumë. Por kjo lidhet edhe me interesimin tim për filmin: deri në çfarë mase kemi të bëjmë me *mise-en-scène*, me një realitet të imagjinuar, të vënë në skenë...

Diona Budima: A i referohet titulli pikërisht kësaj? *Barinj pa dele*?

Franziska Von Stenglin: Po, pikërisht. A janë ata ende barinj, apo po e bëjnë këtë vetëm për kamerat? Natyrisht, nuk dua të them se nuk ka më barinj në Shqipëri. Ka shumë, jam e sigurt se kishte shumë edhe në kohën kur janë realizuar këto fotografi. Por, po, kjo është pjesë e çështjes, gjithë ky inskenim.

Unë bëj filma dokumentarë artistikë, por edhe në ta ka shumë *mise-en-scène*, shumë inskenim. Hapi im i ardhshëm është të bashkëpunoj edhe më ngushtë me protagonistët e filmave të mi. Meqë xhiroj në film, duhet ta di saktësisht çfarë do të xhiroj dhe kur, sepse nuk kam shumë material filmik. Nuk mund ta lë kamerën të punojë pa ndërprerë.

Prandaj duhet të bashkëpunosh me protagonistët dhe t'u thuash: "Mirë, në njëfarë kuptimi, ata do të aktrojnë më shumë, por do të aktrojnë vetveten në jetën e tyre reale. Do ta riluajnë jetën e tyre", apo diçka të tillë. Nuk e di. E kam të vështirë ta shpjegoj... Kjo është ajo që po them: e kam të vështirë t'i përcaktoj gjërat, sepse as vetë nuk i kuptoj plotësisht.

Diona Budima: Po, por mendoj se gjërat më interesante dalin pikërisht kur nuk i kupton plotësisht.

Franziska Von Stenglin: Mendon?

Diona Budima: Po.

Franziska Von Stenglin: Po. Në fund të fundit, kur punon si artiste, të paktën unë, mbështetem shumë te intuita. Kur e ndiej me barkun tim: "Ah, po, kjo është e mirë." Njëkohësisht, jam gjithmonë e vetëdijshme për njerëzit me të cilët punoj. Pyes veten nëse mënyra si e realizoj punën, për shembull

mënyra si xhiroj, është e dobishme edhe për personin me të cilin po punoj. Në fund të fundit, po e filmoj atë dhe ai po më jep diçka.

Prandaj dua edhe unë të jap diçka në këmbim. Dua ta respektoj atë person, ta respektoj atë që është dhe mënyrën si është, dhe ta paraqes në një mënyrë të mirë, në mënyrë që të ndihet i parë dhe i vlerësuar. Kur punoj me film, edhe këtu, ishte e rëndësishme për mua ta respektoja këtë arkiv, ta respektoja këtë trashëgimi, apo diçka të tillë.

Nuk e di, kur e them kështu tingëllon sikur jam shumë e ndërgjegjshme, madje paksa pretencioze. Por pyetja ishte: si mund t'i shërbejë kjo punë vendit ku kam ardhur? Si mund të bëj diçka që të mos mbetet thjesht një ndërhyrje që e realizoj dhe pastaj e marr me vete? Si mund të mbetet diçka këtu? Dhe, që tani, kjo po sjell rezultate interesante.

Për shembull, një mik i yni po shihte punën e një artisti tjetër që kishte ardhur të premten dhe tha: "Si ka mundësi që ju kanë lejuar t'i merrni këto origjinale? Si ju kanë dhënë fotografitë origjinale? Është e çmendur!" Dhe unë mendova: "Po, interesante." Sepse ai nuk e kuptonte se këto nuk janë vepra arti.

Nuk janë vepra arti. Janë katalog. Janë inventar. Nuk e kuptojnë se fotografitë janë ngjitur me ngjitës në këta kartonë. Pra, nuk kemi të bëjmë me një arkiv fotografik në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por me një material funksional. Megjithatë, kur e vendos në mur në një institucion arti, kuptimi i tij ndryshon.

Automatikisht shihet si diçka më e çmuar. Dhe atëherë mendova: "Mirë, ndoshta kjo punë tashmë po e kryen funksionin e vet." Ndoshta disa njerëz do të reagojnë kështu: "Çfarë? Ne e kemi këtë? Kjo nuk duhet të jetë këtu!"

Ndoshta... Dhe këtu dua të them diçka kritike. Shpresoj të mos ketë problem. Për shembull, ekziston Muzeu i Fotografisë në Shkodër, ku ruhet arkivi Marubi. Në fakt, është përvojë zhgënjyese, sepse hyn brenda dhe sheh një fond të jashtëzakonshëm fotografik të këtyre fotografëve, por ekspozita e përhershme nuk paraqet printimet origjinale.

Është një lloj strukture, diçka tjetër. Kur merresh me fotografi dhe ke përvojë me printime të vjetra, me printime të kohës, e di se ato kanë një cilësi që është jashtëzakonisht e vështirë të arrihet sot, për shkak të dallimeve në kimikate dhe në letër. Prandaj, kur ke printime të vjetra, duhet t'i ekspozosh ato. Tonet e grisë dhe thellësia e imazhit kanë një cilësi që është shumë e vështirë të riprodhohet sot.

Isha atje dhe fola me njerëz të tjerë që kishin të njëjtin mendim. Pyesja veten: "Pse nuk po i ekspozojnë? Me siguri kanë pirgje e pirgje me vepra origjinale. Pse nuk i vendosin në korniza dhe nuk i ekspozojnë?" Ndoshta kanë probleme financiare, por institucioni dukej sikur financohej mjaft mirë.

Nuk e di. Por, po, mendova: "Dreqi ta hajë! Kjo është..." E them këtë sepse dikush erdhi këtu dhe bëri një koment të ngjashëm. Tha: "Sa bukur që shihen këtu printimet origjinale!" Por nuk janë printime origjinale të ekspozuara në mënyrën tradicionale; janë thjesht të ngjitura në karton. Megjithatë, nuk ka xham përpara tyre, gjë që bën dallim. Tani mund ta shohësh vetë objektin, ashtu siç është.

Diona Budima: Po. Duket se ky projekt ka lindur vërtet nga koha që keni kaluar këtu.

Franziska Von Stenglin: Po, plotësisht.

Diona Budima: Doja të pyesja se me çfarë ideje fillestare keni ardhur këtu, nëse kishit një të tillë, si ndryshoi ajo dhe si lidhet ky projekt me punën tuaj të mëparshme?

Franziska Von Stenglin: Kur erdha këtu, propozova të hulumtoja punën e Xhanfize Keko-s, regjisores që punonte gjatë periudhës së Kinostudios. Pashë shumë nga filmat e saj dhe lexova për të, por... nuk e dija tamam çfarë do të bëja. Nuk jam artiste që punon me arkiva në atë mënyrë... Më falni, nuk jam artiste hulumtuese në atë kuptim. Nuk e ndieja se duhej të merrja materialet dhe të bëja një film prej tyre, apo diçka të tillë.

Thjesht nuk e dija çfarë të bëja me to. Pastaj zbulova edhe gjithë këta regjisorë të tjerë të mrekullueshëm në arkiv dhe, në fakt, mendova — nuk duhet ta them shumë me zë të lartë — se Xhanfize Keko nuk është më e preferuara ime. Edhe pse është grua, sigurisht që mund të vërehet një dallim: buxhetet që kishte ajo nuk ishin të njëjta me ato të Dhimitër Anagnostit. Ajo bënte filma për fëmijë dhe, duke parë rëndësinë që u jepej këtyre filmave, mund ta dallosh ndryshimin.

Një nga filmat e mi të preferuar të saj është *Beni ecën vetë*. Por, po, kalova shumë kohë në arkiv dhe pastaj gjithçka mori rrjedhën e vet. Edhe stafi këtu është fantastik. Na mundësojnë t'i shohim të gjitha këto vende dhe na njohin me njerëz e arkiva të ndryshme.

Pastaj shkova në arkiv dhe i pashë fotografitë. Në fakt, arkivat më kishin ofruar një nga përvojat e mia të para... jo, jo punën e parë. Kur e përfundova studimet bachelor në fotografi, në vitin 2008 — para dy vjetësh, jo! [qesh] Gjithsesi, para një kohe, realizova një punë me arkivin familjar, me fotografi nga familja e gjyshërve të mi. Ato ruheshin në shtëpinë tonë, nëpër kuti. I mora fotografitë e vjetra bardhezi dhe pastaj shkova në vendet ku kishte jetuar familja ime, sepse pas luftës kishte pasur shumë shpërngulje.

U ktheva në vendet ku familja ime kishte jetuar dikur dhe i fotografova përsëri. Fotografova edhe miqtë e mi dhe krijova disa diptikë të vegjël, duke vendosur pranë njëra-tjetrës fotografinë e vjetër dhe atë të re, për të treguar se si kishin ndryshuar vendet. Kjo punë lidhet shumë me atë projekt, edhe pse është realizuar shumë kohë më parë. Arkivi është gjithashtu diçka që e përdor vazhdimisht në filmat e mi.

Më pëlqen të përdor gjërat që ekzistojnë tashmë, në vend që të prodhoj vazhdimisht gjëra të reja. Ka kaq shumë pasuri në materialet që kemi. Edhe vetë nuk prodhoj shumë, sepse në art kam një lloj pakënaqësie me prodhimin e vazhdueshëm, me objektet dhe me shndërrimin e tyre në mallra. Ndoshta kjo vjen nga prirja ime antikapitaliste. Më pëlqen...

Diona Budima: Ndoshta ju intereson më shumë ndryshimi i këndvështrimit dhe krijimi i një mënyre tjetër të të treguarit...

Franziska Von Stenglin: Po, dhe krijimi i përmbajtjes. Kjo është edhe një arsye pse më pëlqen filmi. Punon me njerëz, ke një ekip. Natyrisht, unë jam regjisorja, por kam pranë gjithë këta njerëz që janë shumë të zotë në atë që bëjnë. I bashkoj dhe e krijojmë punën së bashku. Pjesa më e bukur është procesi i realizimit të filmit, jo vetëm produkti i përfunduar. Edhe ndarja e tij me të tjerët është e bukur, por mbi të gjitha është krijimi i përvojave njerëzore së bashku. Dhe, po, ndoshta edhe ndryshimi i fokusit.

Diona Budima: Si e shihni të ardhmen e këtij projekti? Mendoni se ka të ardhme?

Franziska Von Stenglin: Olsi dëshiron të botojë një libër [qesh], dhe do të ishte vërtet shumë bukur. Ai ka shkruar për fotografinë dhe antropologjinë. Mendoj se Doruntina po e lexon anash tani — është një tekst prej 20, 50 faqesh [qesh]. Në shqip. Unë nuk e kam lexuar, sepse është në shqip, besoj. Ai tha se do të ishte mirë të bënim diçka dhe ta përfshinim në këtë botim edhe përzgjedhjen që kam bërë. Do të ishte e mrekullueshme.

Diona Budima: Po.

Franziska Von Stenglin: Po pres me padurim bisedën tonë të sonte. Nuk e di. Shpresoj që kjo të konkretizohet një ditë përmes një muzeu. Nuk po them se unë do të jem arsyeja që do të ndodhë. Thjesht shpresoj që një ditë këto punime të ekspozohen, bashkë me shumë të tjera. Shpresoj që njerëzit të gjejnë në to kënaqësi, por edhe arsye për të menduar, material që i nxit të hulumtojnë, të bëjnë pyetje, të kuptojnë dhe të... Po.

Diona Budima: A mund të flisni pak për ndikimet tuaja? A ka tekste, artistë të tjerë apo edhe njerëz në rrethin tuaj të afërt që kanë ndikuar në mënyrën se si punoni ose në atë që shpresoni të arrini?

Franziska Von Stenglin: Uf! Çfarë më pëlqen? Zot, më zuri në befasi kjo pyetje [qesh].

Diona Budima: Mund edhe të mos përgjigjeni.

Franziska Von Stenglin: Sa i përket fotografisë... Zot, janë kaq shumë! Për shembull, August Sander, fotografi gjerman, i cili realizonte portrete të njerëzve në profesionet e tyre, së bashku me veglat e punës. Ka edhe disa fotografi të Marubit që më kujtojnë punën e tij. Për shembull, një kuzhinier me të gjitha veglat e kuzhinës. Janë fantastike. Është edhe fotografja Dayanita Singh nga India. Ajo vjen nga një familje me prejardhje të privilegjuar kulturore dhe shoqërore.

Ajo fotografoi dhe dokumentoi familjen e saj. Më pas e zgjeroi praktikën e vet dhe filloi të punonte edhe me rrethana të tjera shoqërore, duke përdorur fotografinë. Është e mrekullueshme. Edhe Manuel Álvarez Bravo është fotograf fantastik. Ja, prapë po më zë në befasi kjo pyetje, sepse gjithmonë harroj emra. E di që ka shumë fotografë të mirë, por jam gjithmonë ajo që nuk i kujton dot.

Sa i përket filmit, është një regjisor meksikan, Carlos Reygadas, i cili ka realizuar një film të mrekullueshëm, *Stellet Licht* (*Silent Night*). Është kryevepër e jashtëzakonshme. Nuk e di nëse do të arrij ndonjëherë të bëj një film aq të mirë sa ai. Dhe nuk ka asgjë të keqe në këtë. Është në rregull, e pranoj dhe e di këtë.

Sa i përket leximit... O Zot, këtu është edhe më keq me emrat. Sapo përfundova një libër, krejt rastësisht, nga Patrick O'Keefe. Quhet *Say Nothing*. Ai është gazetar, por librin e ka shkruar për IRA-n dhe ka përdorur shumë arkiva. Disa njerëz kishin regjistruar anëtarët e IRA-s dhe kishin mbledhur intervista gojore, ashtu siç po bëjmë ne tani.

Në fakt, po, pikërisht këtë po bëjmë tani. Ata kishin bërë të njëjtën gjë, por në një kontekst tjetër. Njerëzit nuk duhej ta dinin se këto intervista po realizoheshin, sepse flisnin për krimet, "krimet" — për gjërat që kishin bërë dhe për njerëzit që kishin vrarë.

Diona Budima: [e padëgjueshme]

Franziska Von Stenglin: [qesh] Dhe ishte një libër i mrekullueshëm. Quhet *Say Nothing*. Është vërtet i

jashtëzakonshëm. Nëse nuk e keni lexuar, ju rekomandoj ta lexoni. Është ndoshta libri i fundit që kam lexuar siç duhet, nga fillimi në fund.

Diona Budima: Pra, thoni se nuk mbani mend asgjë, e pastaj vazhdoni të përmendni plot gjëra [qesh].

Franziska Von Stenglin: [qesh] Po, ky është vetëm një shembull i vogël... Nuk e di. Po, po. Edhe Tina Modotti, fotografja meksikane.

Diona Budima: Për ta përmbyllur, a mund të na tregoni se çfarë ju emocionon apo ju ngjall interes më së shumti aktualisht, qoftë në aspektin personal, politik apo artistik?

Franziska Von Stenglin: Politikisht? [qesh] Çfarë mund të jetë emocionuese politikisht? Gjithçka është dëshpëruese. Ajo që më gëzon është koha që kam kaluar këtu dhe njerëzit me të cilët e kam ndarë këtë përvojë. Jam shumë mirënjohëse për këtë kohë, edhe pse ndonjëherë, madje shpesh, ka qenë jashtëzakonisht e vështirë. Por, përsëri, gjithçka lidhet me njerëzimin, me atë që na bën njerëzorë. Të kalosh tre muaj në këtë vend, me artistët e tjerë rezidentë dhe me njerëzit që punojnë këtu, është thjesht një dhuratë. Është shumë bukur. Kjo ishte edhe frika ime më e madhe: se njerëzit mund të mos ishin të këndshëm ose se grupi mund të ishte i çuditshëm. Por, në fakt, doli të ishte një përvojë vërtet e mrekullueshme.

Nuk ka qenë pa vështirësi, por është dhuratë të mund të kalosh tre muaj duke u përballur edhe me të gjitha ato vështirësi. Nuk mund thjesht të largohesh e të mos merresh më me to; duhet të kthehesh çdo mëngjes dhe t'i takosh të njëjtët njerëz. Kështu që duhet t'i zgjidhësh konfliktet dhe të përballesh me dallimet. Kujtimi më i bukur që do të marr me vete është ai i të gjithëve ulur rreth një tavoline. Kjo ka ndodhur disa herë, ose ndoshta ka qenë vetëm një pjesë e grupit, por gjithsesi, mblidheshim njerëz nga vende të ndryshme dhe bisedat shpesh fillonin me ushqimin. Dikush thoshte: "Uau, kjo është shumë e mirë! Në vendin tonë e bëjmë kështu, e gatuajmë ashtu dhe e përgatisim në këtë mënyrë." Pastaj dikush tjetër thoshte: "Po, është shumë e ngjashme edhe tek ne. Ne e bëjmë kështu." E pastaj dikush tjetër ndërhynte: "Jo, tek ne është krejt ndryshe..." e kështu me radhë.

Është një përpjekje e vazhdueshme për ta kuptuar tjetrin, i cili është shumë i ndryshëm nga ti, për të kuptuar si i bën gjërat dhe pse i bën në atë mënyrë. Zakonisht është më e lehtë të mos merresh me njerëz që janë të ndryshëm nga ti, të mos përpiqesh t'i kuptosh apo të kuptosh prej nga vijnë. Por në një vend si ky, je i detyruar ta bësh këtë. Dhe kjo është diçka e bukur.

Diona Budima: Në rregull. Faleminderit shumë.

Franziska Von Stenglin: Faleminderit që më dhatë mundësinë të flisja.